REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr._____Prot. Maliq, më 21.02.2025

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e **premte, më datë 28.02.2025, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.01.2025.
4. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin janar 2025";
5.P-V "Për miratimin e bursave për nxënsit e arsimit të mesëm nga buxheti i bashkisë për vitin shkollor 2024-2025";
6.P-V "Për miratimin e Raportit të III-të të Monitorimit të buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024";
7-P-V "Për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga të ardhurat e veta";
8-P-V "Për transferimin e materialeve të magazinës së Bashkisë Maliq, Agjencisë së Shërbimeve Mbështetëse";
9.P-V "Për marrjen e ambienteve me qira, për Pensionistët në fshatin Sheqeras Njësia Administrative Vreshtas";
10.P-V " Për miratimin e listës të kullotave, të gatshme për kullotje dhe kositje për sezonin 2025 dhe miratimin e kontratës tip të dhënies me qira për kullotje";
11.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.Spiro Roko banues në bllokun nr.4 Maliq, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit";
12.P-V "Për dërgimin për bashkëfimincim të projektit *"Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizura"*për vitin 2025";
13.Miratimin e raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë keshillit bashkiak *"Mbi heqjen e mandatit të znj. Rudina Bregu"*, pas kërkesës për dorëheqje.
14.Informacion nga Zyra e Integrimit Europian dhe Koordinimit të Ndihmës të Huaj, lidhur me çështje të kërkuara nga Këshilli Bashkiak.
15.Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e Mërkurë nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut. Pika 4 e rendit të ditës.
znj.Nersida Shindo, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari.

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjiktë Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat 6,7,8,9 e rendit të ditës.
z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes. Pikat 5, 9 e rendit të ditës
znj.Albina Xhejo, z.Faslli Zholi, z.Lulëzim Hoxhaj, znj.Gentina Drabo, znj..Daniela Ibrahim.

Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujrave, Mbrojtjes së Mjedist dhe Biodiversitetit. Pika 10 e rendit të ditës, z.Fevri Sherifi, znj.Rovena Terolli, znj.Marianthi Avrami.

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit. Pika 11 e rendit të ditës, z.Dritan Çami, z.Ilia Xhuti, znj.Floreta Zaçe, znj.Eglantina Balli, z.Yllson Ibrahimllari

Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit. Pika 12 e rendit të ditës, z.Idlir Limllari, z.Eriseld Jonusllari, znj.Pranvera Begolli, z.Almir Elezi z. Faslli Zholi.

Komisioni Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare. Pika 13 e rendit të ditës, znj.Pranvera Begolli, z.Petrit Kupe, znj.Nersida Shindo, znj.Eglantina Balli.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI